



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, një ekspert i identifikimit të ADN-së dha dëshmi të premtën e shkuar më 16 qershor.

Gjatë së njëjtës seancë, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër me gojë me të cilin caktoi disa data të synuara për muajt në vijim në këtë çështje gjyqësore. 6 korriku është data në të cilën synohet mbyllja e paraqitjes së provave nga Prokuroria. Më pas, në varësi të rezultatit të ndonjë mocioni prej Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave, 21 ose 22 gushti është data në të cilën synohet që fillimi i paraqitjes së provave nga mbrojtësi i viktimave, nëse dëshiron. Së fundi, Trupi Gjykues caktoi 18 shtatorin si datën në të cilën synohet të fillojë paraqitja e provave nga Mbrojtja.

Seancat në këtë çështje gjyqësore janë planifikuar të rifillojnë të hënën e ardhshme.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, seancat u mbajtën të hënën dhe të martën e kësaj jave. Dëshmitari i dhjetë dhe i njëmbëdhjetë të thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhanë dëshmi dhe iu përgjigjën pyetjeve të Prokurorisë, Mbrojtjes, mbrojtësit të viktimave dhe gjykatësve.

Të hënën, më 19 qershor, Trupi Gjykues shprehu shqetësimin për ritmin se si po ecin seancat në këtë çështje gjyqësore dhe u kujtoi palëve se është e panevojshme t'i pyesin dëshmitarët me hollësi për aspekte të pakontestuara.

Të martën, më 20 korrik, dëshmitari i njëmbëdhjetë përfundoi dëshminë dhe pas kësaj Trupi Gjykues diskutoi gjerësisht me palët dhe mbrojtësin e viktimave për hapat konkretë që mund të ndërmerren për të garantuar një numër më të madh seancash publike në këtë çështje gjyqësore. Diskutimi u mbështet në parashtrimet me shkrim që Trupi Gjykues kishte marrë nga Prokuroria, Mbrojtja dhe mbrojtësi i viktimave. Kryegjykatësi theksoi se të gjithë pajtohen se duhet promovuar një procesi gjyqësor publik. Në fund të seancës, ai bëri me dije se ka gjasa që Trupi Gjykues t'i mbledhë përsëri palët dhe pjesëmarrësit për të diskutuar propozimet e bëra dhe u kërkoi Prokurorisë dhe Mbrojtjes që të japin ndihmën e tyre për të trajtuar këtë aspekt.

Seanca vijuese në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* është planifikuar për të hënën, 10 korrik, në orën 9:00 të paradites.

Krahas seancave të kësaj jave, pati edhe disa parashtrime e vendime të reja në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*.





Më 16 qershor, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave i dorëzoi një raport Trupit Gjykses në të cilin paraqiti kërkesën e ndryshuar të një viktime që i ishte rrëzuar më parë kërkesa dhe rekomandoi që ky person të pranohej si pjesëmarrës në procesin gjyqësor.

Më 16 qershor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, në vendime më vete për secilin. Për dy të akuzuarit, Trupi Gjykses konstatoi se ekziston ende rreziku që mund të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor apo të kryejnë krime të tjera. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi, në lidhje me të dy të akuzuarit, se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve të Njesisë së Paraburgimit të DHSK-së.

Më 21 qershor, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi dy apele kundër Vendimit të Pestë të Trupit Gjykses mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, që u paraqitën në emër të 37 personave të cilëve u ishte refuzuar kërkesa. Ndër të tjera, Trupi Gjykses konstatoi se krimet që personat pretendonin se kishin vuajtur nuk përfshiheshin në kuadrin gjeografik apo material të Aktakuzës. Paneli i Apelit konstatoi se mbrojtësi i viktimave të refuzuara nuk u vërtetoi se Trupi Gjykses kishte bërë konstatim të gabuar dhe, për rrjedhojë, e rrëzoi mocionin.

Gjithashtu, më 21 qershor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për kufizimin e pjesëmarrjes në sallën e gjyqit dhe urdhëroi që një nga anëtarët e ekipit të Mbrojtjes të mos jetë i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë dëshmisë së dëshmitarëve me masa mbrojtëse.

Gjykatësit konstatuan se prania e një anëtari të ekipeve të Mbrojtjes, që është i afërm i ngushtë i një personi që pretendohet se ka marrë pjesë në disa nga krimet e paraqitura në Aktakuzë, me të drejtë mund të perceptohet nga dëshmitarët si cenim i sigurisë, mirëqenies, dinjitetit apo privatësisë së tyre dhe dëshmitarët mund të kenë frikë të japin dëshmi të plotë dhe të sqartë, çka bie ndesh me kërkimin e së vërtetës dhe të drejtësisë, çka nuk do të ishte e drejtë.

Gjykatësit po ashtu bënë të qartë se kjo nuk do thotë se anëtari i ekipit të Mbrojtjes kishte shkelur Kodin e Etikës dhe se nuk bëhej asnjë konstatim negativ sa i takon sjelljes profesionale të atij personi.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, versioni i redaktuar publik i një vendimi të mëhershëm të Trupit Gjykses që miratoi pjesërisht kërkesën e z. Thaçi për vizitë nën ruajtje në Kosovë, për arsye humanitare, mund të gjendet në faqen e internetit të DHSK-së. Kjo vizitë nën ruajtje u krye më 29 maj.

Së fundi: informimi i rregullt javor për javën e ardhshme do të mbahet të mërkurën, më 26 qershor në orën 14:30, për arsye se enjtja është pushim zyrtar për DHSK-në.

Pyetje nga gazetarët

